



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KUÇOVË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. Prot 3734

Kuçovë më 02/10/2023

VENDIM

Nr. 35 . Datë 31/10/2023

“Mbi mbylljen e Institucionit Arsimor shkolla “Partizani” Rreth-Tapi dhe Gjimnazit “Myrteza Kepi” Kuçovë dhe bashkimin e tyre në SHMB “Myrteza Kepi” Kuçovë.”

Bazuar në Ligjin Nr. 69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Urdhrin Nr 31 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit datë 28.01.2020 “Për Miratimin e Rregullores për Funksonimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare”, Udhëzimin Nr.12 datë 10.06.2021 të MAS “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar”, i ndryshuar, Udhëzimin Nr.14 datë 10.07.2023 “Për numrin e nxënësve në klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimorë në institucionet e arsimit parauniversitar”, VKM nr.662, datë 08.10.2014 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për hapjen dhe për mbylljen e institucioneve arsimore parauniversitare publike”, Vendimin për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr. 662, datë 08.10.2014 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për hapjen dhe për mbylljen e institucioneve arsimore parauniversitare publike dhe për shkak të rënies së numrit të nxënësve nën numrin e lejuar që institucioni arsimor publik të ketë juridiksion, drejtor e vullë të veçantë,

VENDOSI:

1. Mbylljen e Institucionit Arsimor shkolla “Partizani” Rreth-Tapi.
2. Mbylljen e Institucionit Arsimor Gjimnazit “Myrteza Kepi” Kuçovë.
3. Bashkimin e tyre në SHMB “Myrteza Kepi” Kuçovë .

Ky vendim u miratua me 20 vota pro, — vota kunder, — vota abstenim në prezencë të 20 këshilltarëve.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Aleksandër ZIU

